

## ÇFARË ËSHTË E RE DHE ÇFARË NUK KA NDRYSHUAR

Ndërsa profesioni kontabël përgatitet për të përmbushur kërkesat për informacion cilësor lidhur me qëndrueshmërinë, kontabilistët profesionistë, akademikët dhe ofruesit e arsimit-formimit, shoqëritë e kontabilitetit dhe organizatat profesionale të kontabilitetit (OPK) duhet të mendojnë si të [plotësojnë boshllëqet](#) në programet e arsimit-formimit kontabël.

Lajmi i mirë është se shumë nga ato që bëjnë tashmë kontabilistët profesionistë mund të vlejë për shërbimet e lidhura me qëndrueshmërinë. Tema dhe vështirësi të tjera të reja të lidhura me qëndrueshmërinë do të kërkojnë mënyra të reja të menduar dhe të punuar. Për këtë duhet siguruar që kontabilistët profesionistë të jenë të pajisur me mjetet e duhura për të hequr rrugën drejt qëndrueshmërisë.

Në kuadër të vëmendjes që IFAC i kushtohen ndërthurjes midis arsimit-formimit dhe qëndrueshmërisë (dhe për të ndihmuar profesionin të mendojë se çfarë arsimit dhe formimi shtesë mund të nevojitet) IFAC ka zhvilluar këtë kornizë arsimit për qëndrueshmërinë që mbulon atë që është e re dhe që ka ndryshuar në katër fusha kryesore të fokusit për profesionistët kontabël.

## EKSPERTIZA TEKNIKE



### TASHMË:

- Nxjerrim raporte financiare cilësore dhe të dobishme për vendimmarrje.
- Interpretojmë të dhënat dhe informacionet jofinanciare.
- Analizojmë të dhënat dhe informacionet në mbështetje të vendimmarrjes së niveleve drejtuese.
- Vlerësojmë mjaftueshmërinë e sistemeve, proceseve dhe sistemeve të kontrollit për raportimin financiar.

### MË TUTJE:

- Do të kuptojmë dhe përdorim standarde dhe kërkesa të reja për raportimin dhe sigurinë lidhur me qëndrueshmërinë.
- Do të krijojmë mënyra të reja për të matur rezultatet, përfshirë metrikë dhe objektiva të mbështetur në shkencë.
- Do të analizojmë lloje të reja të grupeve të të dhënave dhe skenarëve lidhur me qëndrueshmërinë, për një vendimmarrjen mbështetur në informacione.
- Do të projektojmë, zbatojmë dhe vlerësojmë sisteme, procese dhe sisteme kontrolli për raportimin e qëndrueshmërisë.
- Do të përdorim gjykimin dhe analizojmë materialitetin për kontekstin e qëndrueshmërisë.
- Do të nxjerrim informacione shpjeguese dhe të dhëna cilësore të qëndrueshmërisë që janë të dobishme për vendimmarrje.

## MPREHTËSIA TREGTARE



### TASHMË:

- Kuptojmë dhe vlerësojmë modelet tregtare në ndryshim.
- Interpretojmë faktorët rregullatorë, ekonomikë dhe të tjerë të jashtëm në kushtet operative të njësisë ekonomike.
- Analizojmë ndikimin e vendimeve strategjike tregtare.
- Hartojmë dhe analizojmë procedura të drejtimit të brendshëm dhe administrimit të rrezikut.

### MË TUTJE:

- Do të mendojmë në sisteme dhe do të marrim parasysh ndikimin e qëndrueshmërisë globale në modelet tregtare, zinxhirët e vlerës dhe strategjitë.
- Do të njohim lidhjen e rreziqeve dhe mundësive financiare dhe të qëndrueshmërisë.
- Do të vlerësojmë ndikimin për drejtimin e brendshëm, rreziqet dhe administrimin e rezultateve.
- Do të sigurojmë për nivelet drejtuese të dhëna dhe informacione mbi qëndrueshmërinë, në mbështetje të vendimmarrjes.
- Do t'u vëmë në dispozicion informacione cilësore dhe të dobishme për vendimmarrje palëve të jashtme të interesit.

## KOMPETENCA E SJELLJES



### TASHMË:

- Stërvitemi për të qenë mendimtarë analitikë.
- Demonstrim qëndrueshmëri, fleksibilitet dhe zhdërvjelltësi intelektuale në mënyrën si punojmë.
- Kemi kureshtje intelektuale dhe mësojmë gjatë gjithë jetës.
- Ndërtojmë marrëdhënie të forta ndërpersonale.
- Punojmë në bashkëpunim mes ekipesh, organizatash, specialitetesh dhe ekspertësh.

### MË TUTJE:

- Do të zbatojmë aftësitë analitike dhe njohuritë kontabël për llojet e reja të dhënave dhe kërkesat e reja të raportimit.
- Do të përdorim të menduarit kritik dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve për të analizuar në mënyrë efektive skenarët e ardhshme, përfshirë rreziqet dhe pasiguri, dhe për të vlerësuar alternativat.
- Do të përshtatem dhe do të jemi të zhdërvjelltë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të reja në përgjigje të aktiviteteve të lidhura me qëndrueshmërinë.
- Do të përmirësojmë më tej aftësitë e bashkëpunimit për të punuar në mënyrë efektive në ekipe shumëdisiplinore dhe me një gamë më të gjerë ekspertësh.
- Do të komunikojmë qartë dhe efektivisht me një gamë më të gjerë palësh interesi të brendshme dhe të jashtme.

## ETIKA DHE VLERA PROFESIONALE



### TASHMË:

- Kemi një bazë të fortë etike përmes respektimit të Kodit të IESBA-së<sup>1</sup> së bashku me çdo kërkesë kombëtare që është më kufizuese.
- Arrijmë dhe mbajmë një nivel njohurish dhe aftësish profesionale për të ofruar shërbime cilësore dhe për të mbrojtur interesin publik.
- Kemi mendje kureshtarë dhe ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional.

### MË TUTJE:

- Do të përdorim standardet e ardhshme të rishikuara dhe të reja të etikës për raportimin dhe sigurinë lidhur me qëndrueshmërinë.
- Do të mbajmë parasysh rreziqet etike në kuadër të qëndrueshmërisë, përfshirë gjatë punës me ekspertë dhe të tjerë.
- Do të përdorim gjykimin profesional dhe skepticizmin gjatë hartimit ose dhënies së sigurisë për informacionet shpjeguese të lidhura me qëndrueshmërinë.

<sup>1</sup> Kodi Ndërkombëtar Etik për Kontabilistët Profesionistë (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës ("Kodi i IESBA-së") publikohet nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistë.

IFAC, me Panelin Ndërkombëtar për Edukimin Kontabël, ka përgatitur këtë kornizë edukimi për qëndrueshmërinë, me:

Mbi 70 diskutime me hartues, auditues, investitorë, akademikë, profesionistë të qëndrueshmërisë, rregullatorë dhe OKP në mbarë botën.

Një anketë me palët e interesit, në arabisht, anglisht, frëngjisht, portugalisht dhe spanjisht, që mori më shumë se 340 përgjigje nga 80 vende.

Një shqyrtim të literaturës, [Edukimi i kontabilistëve për një të ardhme të qëndrueshme](#), në partneritet me Shoqatën Ndërkombëtare për Edukimin dhe Kërkimin Kontabël.

